



Republika e Kosovës

Republika Kosovo

Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Istog

Skupština Opštine Istok

Municipal Assembly Istog

Komiteti për Politikë dhe Financa/Komitet za Politiku i Financije/ Policy and Finance Committee

Nr. 35	Procesverbal
Tipi i mbledhjes:	Mbledhje e Rregullt e KPF-së
Data e mbajtjes:	23.01.2025 në ora 10:00
Mbledhjen e kryesoi:	Enver Rugova, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Istogut
Procesmbajtës:	Flora Bujupaj Asistente Administrative pranë Zyrës së Kryesuesit të Kuvendit
Pjesëmarrës anëtarët e KPF-së	Hajrush Shoshi, Faruk Kabashi, Ardita Idrizaj, Ajshe Metaj dhe Arjan Shatri.
Mungojnë:	Liridona Lajçi.
Pjesëmarrës të tjerë:	Kryetari i Komunës Ilir Ferati, Nënkryetari i Komunës Ali Nimanaj, Drejtorët: Genc Ademaj, Agon Dreshaj, Astrit Hajrizaj, Abedin Kabashi, Arben Kabashi, Kushtrim Buleshkaj, Merita Bytyçi, Vlora Vuthaj, Zenel Shatri, Naim Behlulaj zyrtar administrativ: Ardon Arifaj dhe OSBE.
Rendi i ditës:	
- Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, - Shqyrtimi i raportit të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2024, - Shqyrtimi i Raportit të punës së Kryetarit për vitin 2024, - Shqyrtimi i Raportit të punës së KKSB-së për vitin 2024, - Shqyrtimi i Raportit financiar për tremujorin e katër, tetor-dhjetor 2024, - Shqyrtimi i Raportit të Planit të Integritetit për vitin 2024, - Shqyrtimi i Raportit të zbatimit të Planit të Veprimit për Transparencë për vitin 2024, - Raporti Vjetor i Ekipit për të Drejtat e Fëmijëve- Istog, - Shqyrtimi i Raportit të Planit Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore 2024-2026, - Raporti i punës së KRM Ambienti Njësia Operative Istog (janar- dhjetor) 2024 - Realizimi i planit Objektivat e menaxhimit të mbeturinave dhe plani operacional 2024, - Raporti i Planit të Veprimit për Energji të Qëndrueshme dhe Klimë, - Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-Vendimit për rishqyrtimin e Vendimit 00 Nr.163/2024 për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2025,	

Diskutimet:

Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova -përshëndeti të pranishmit.

Konstaton se të pranishëm janë 6 anëtarë të KPF-së prezent, kushtet janë plotësuar për mbajtjen e mbledhjes Hapi punimet për këtë mbledhje me pikat e rendit të ditës të parapara për ditën e sotme.

Prezanton rendin e ditës,

Fton ekzekutivin si dhe anëtarët e KPF-së nëse dikush ka ndonjë pyetje sugjerim apo ndonjë propozim për rend dite? Drejtori Genc Ademaj e ka fjalën.

Genc Ademaj- propozon dy pika të reja për rend dite Plotësim -Ndryshimi i Rregullores 00 Nr. 177/202 për Taksa Ngarkesa dhe Gjoba, dhe Rishqyrtimi i Rregullores 00 Nr. 189/2024 për Shitjen e Mallrave Artikujve dhe shërbimeve tjera jashtë lokaleve afariste. Ka të bëjë me Rregullore që janë aprovuar më herë ligjshmëria e tyre është kthyer pozitive, te Rregullorja për Taksa Ngarkesa dhe Gjoba ka ardhur një rekomandim nga Ministria e Bujqësisë, edhe pse vitin e kaluar për të njejtën bazë ligjore të neni 11, i kemi hequr tri paragrafe me një plotësim ndryshim të Rregullores, tash këtë vit duhet të përfshihen. Ndërsa sa përket Rregullores tjetër për Shitjen e Mallrave, Artikujve dhe shërbimeve tjera jashtë lokaleve afariste, në kanë rekomanduar që pas nenit të të Rregullores të përfshihen edhe disa nene të Ligjit për Tregtinë Brendshme, veç shtohet një bazë ligjore, Rregullorja është në fuqi, këto veç çka e fuqizojnë Rregulloren.

Gjithashtu duhet cekur që materiali për Raportin e punës së Kryetarit për shkaqe që nuk ka qenë kompletuar nuk e kemi dërguar të mangët, por nesër pasdite do ta keni materialin e kompletuar. Tash si të doni, mundemi edhe me e heq nga rendi i ditës por ju kisha lutur për mirëkuptim.

Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova -jo ne kur e kemi për shpejt, e lëmë.

Genc Ademaj- Raporti i Punës së Kryetarit nuk është raport i veçantë, është raport i përbërë prej të gjithë sektorëve, sepse edhe kur bëhet publikimi i raporteve të punës apo planeve të veprimit të drejtorive, bëhen ndaras.

Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova - propozon si pikë të rendit të ditës Njoftimi me Raportin Vjetor për kontratat e nënshkruara publike. Materiali ka ardhur më vonë se kur e kemi dërguar në ftesën.

Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova pasi që nuk ka propozime të reja të tjera, hedh në votim kush është i hyn në rend dite pika e parë e propozuar nga drejtori Genc Ademaj? Plotësim -Ndryshimi i Rregullores 00 Nr. 177/2024 për Taksa Ngarkesa dhe Gjoba?

Miratohet unanim nga 6 anëtarë të pranishëm të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova- hedh në votim, kush është i hyn në rend dite pika e dytë e propozuar nga drejtori Genc Ademaj? Rishqyrtimi i Rregullores 00 Nr. 189/2024 për Shitjen e Mallrave Artikujve dhe shërbimeve tjera jashtë lokaleve afariste?

Miratohet unanim nga 6 anëtarë të pranishëm të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova- kush është i hyn në rend dite pika e tretë e propozuar nga kryesuesi Njoftimi me Raportin Vjetor për kontratat e nënshkruara publike?

Miratohet unanim nga 6 anëtarë të pranishëm të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Hedh në miratim rendin e ditës për ditën e sotme me 3 pikat e propozuara për ditën e sotme?

Kush është që të miratohet rendi i ditës?

Unanim Miratohet rendi i ditës për mbledhjes e sotme.

Prezent në mbledhje janë 6 anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Vendimet:

Miratohet unanim rendi i ditës për mbledhjen e sotme.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 1.

Diskutimet:

Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova, vazhdojmë më pikën e parë të rendit të ditës' Shqyrtimi dhe miratim i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. A ka dikush diçka rreth procesverbalit?

Pasi që nuk ka diskutime.

Hedh në votim, kush është që të miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar?

Miratohet unanim procesverbali nga mbledhja e kaluar pa vërejtje.

Vendimet:

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 2.

Diskutimet:

Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova - vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës. Shqyrtimi i raportit të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2024, kemi punuar në të, janë të përmbledhura të gjitha që kanë ndodhur gjatë këtij viti, është i fundit për këtë legjislaturë, nuk është i rënduar, por është pak i zgjeruar në tërësi. A ka dikush diçka? Pasi nuk ka diskutime.

Hedh në votim pikën e rendit të ditës?

Nga anëtarët e KPF-së votohet unanim që kjo pikë t'i kaloj Kuvendit të Komunës për shqyrtim.

Gjashtë anëtarë prezent në mbledhje.

Vendimet:

Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF - ja unanim ia kalon kuvendit të komunës për shqyrtim Raportin e punës së Kuvendit Komunal për vitin 2024.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 3.

Diskutimet:

Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova, vazhdojmë me pikën e tretë. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kryetarit për vitin 2024. Drejtori e dha atë që është i pa kompletuar për arsye objektive. Nesër pasdite besoj që do të jetë i kompletuar dhe do e dërgojmë materialin.

Kryesuesi i Kuvendit - Hedh në votim:

Nga anëtarët e KPF-së votohet unanim që kjo pikë t'i kaloj Kuvendit të Komunës për shqyrtim.

Gjashtë anëtarë prezent në sallë.

Vendimet:

Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja unanim, ia kalon Kuvendit të Komunës pikën e rendit të ditës 'Shqyrtimi i Raportit të punës së Kryetarit për vitin 2024.

Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
--	-------------------------------

Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
--------------------------	------------------------------

Shqyrtimi i pikës 4.

Diskutimet:

Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova, - po vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës. Shqyrtimi i Raportit të punës së KKS-së për vitin 2024.

Skender Hasangjekaj- prezanton pikën e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Genc Ademaj.

Genc Ademaj- një sqarim sa i përket shtesës sepse ka ndryshuar edhe rregulla e pagesës së pagave. Për çdo muaj jemi të obliguar që si të gjitha shpenzimet tjera edhe kategoria e pagave të zotohet për procesim. D.m.th. nuk bëhet alokimi paraprak. Nuk ka rimbursime sikur që ka pasur në vitet e mëparshme. Këtë vit pjesa e pagave është e paprekshme ligjrisht. Te KKS-jë është vërtet një formë e shtesës përmes subvencionimit të anëtarëve të këtij komiteti. Në anën profesionale po them që është keq klasifikim. Nëse ne realizojmë kontratë përmes prokurimit për anëtarët e komisionit atëherë lejohet nga kategoria e mallrave se llogaritet si shërbim profesional. Te kjo pjesë mundemi me e bërë një program me e bërë kalkulim e mbledhjeve dhe të anëtarëve të komisionit me e caktuar ju një tarifë që është realisht adekuate pastaj me e fut në Kuvend edhe me ndarë buxhetin nga kategoria e subvencioneve kur vjen koha e bartjeve të tejkalimeve të të hyrave vetanake që mendojmë të bëhet në muajin shkurt të këtij viti.

Kryesuesi i Kuvendit- shumë komuna e kanë bërë kështu siç po thua ti drejtor. Edhe pastaj vijnë anëtarët sepse tani nuk mundesh me i obliguar të vijnë.

Genc Ademaj- është edhe një formë tjetër që të gjitha komitetet që nuk janë të përhershme me e nxjerrë një Rregullore edhe me i caktuar tarifat për të gjitha komisionet. Ju kisha sugjeruar ta bëni një Rregullore e sa përket pjesës financiare e bëjmë një zgjidhje.

Kryesuesi i Kuvendit - Hedh në votim:

Nga anëtarët e KPF-së votohet unanim që kjo pikë t'i kaloj Kuvendit të Komunës për shqyrtim.

Gjashtë anëtarë prezent në sallë.

Vendimet:	
Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja unanim, ia kalon Kuvendit të Komunës për shqyrtim Raportin e punës së KKSB-së për vitin 2024.	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 5.	
Diskutimet:	
Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova, - po vazhdojmë më pikën e pestë të rendit të ditës. Shqyrtimi Raportit financiar për tremujorin e katër, tetor-dhjetor 2024.	
Genc Ademaj- prezanton pikën e rendit të ditës 'Shqyrtimi i Raportit financiar për tremujorin e katër, tetor-dhjetor 2024'.	
Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova - hapi diskutimin, pasi që nuk ka diskutime.	
Kryesuesi i Kuvendit- Enver Rugova, Hedh në votim:	
Miratohet unanim nga anëtarët e KPF-së.	
Gjashtë anëtarë prezent në sallë.	
Vendimet:	
Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja unanim, ia kalon Kuvendit të Komunës për shqyrtim Raportin financiar për tremujorin e katër, tetor-dhjetor 2024.	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 6.	
Diskutimet:	
Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova, - po vazhdojmë më pikën e gjashtë të rendit të ditës. Shqyrtimi i Raportit të Planit të Integritetit për vitin 2024.	
Genc Ademaj- të gjitha këto raporte ligjërish e kemi obligim të sjellim në Kuvend. Arsyeja është te pjesa përformancës. Pak a shumë është veç një njoftim, sepse këto as nuk shkojnë në ministri as për shqyrtim të ligjshmërisë.	
Kryesuesi i Kuvendit - Hedh në votim:	
Miratohet unanim nga anëtarët e KPF-së.	
gjashtë anëtarë prezent në sallë.	
Vendimet:	
Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja unanim, ia kalon Kuvendit të Komunës për shqyrtim Shqyrtimi i Raportit të Planit të Integritetit për vitin 2024.	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 7.	
Diskutimet:	
Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova, - po vazhdojmë më pikën e shtatë të rendit të ditës. Shqyrtim Raportit të zbatimit të Planit të Veprimit për Transparencë për vitin 2024. E hapi diskutimin pasi nuk ka dikush diçka. Pasi që jo, Kryesuesi i Kuvendit - Hedh në votim: Miratohet unanim nga anëtarët e KPF-së. Gjashtë anëtarë prezent në sallë.	
Vendimet:	
Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja unanim, ia kalon Kuvendit të Komunës për shqyrtim Raportin e zbatimit të Planit të Veprimit për Transparencë për vitin 2024.	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 8.	
Diskutimet:	
Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova, - po vazhdojmë më pikën e tetë të rendit të ditës. Raporti Vjetor Ekipit për të Drejtat e Fëmijëve- Istog. Pyet a ka dikush diçka pasi që jo. Kryesuesi i Kuvendit - Hedh në votim: Miratohet unanim nga anëtarët e KPF-së. Gjashtë anëtarë prezent në sallë.	
Vendimet:	
Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja unanim, ia kalon Kuvendit të Komunës për shqyrtim Raportin Vjetor i Ekipit për të Drejtat e Fëmijëve- Istog.	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 9.	
Diskutimet:	
Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova, - po vazhdojmë më pikën e nëntë të rendit të ditës. Shqyrtimi Raportit të Planit Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore 2024-2026. E hapi diskutimin, pasi që nuk ka diskutime. Kryesuesi i Kuvendit - Hedh në votim: Miratohet unanim nga anëtarët e KPF-së. Gjashtë anëtarë prezent në sallë.	

Vendimet:	
Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja unanim, ia kalon Kuvendit të Komunës për shqyrtim Raportin e Planit Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore 2024-2026.	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 10.	
Diskutimet:	
Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova, - po vazhdojmë më pikën e dhjetë të rendit të ditës. Raporti i punës së KRM Ambienti Njësia Operative Istog (janar- dhjetor)2024. E hapi diskutimin, pasi që nuk ka diskutime.	
Kryesuesi i Kuvendit - Hedh në votim: Miratohet unanim nga anëtarët e KPF-së. Gjashtë anëtarë prezent në sallë.	
Vendimet:	
Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja unanim, ia kalon Kuvendit të Komunës për shqyrtim Raporti i punës së KRM Ambienti Njësia Operative Istog (janar- dhjetor)2024.	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 11.	
Diskutimet:	
Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova, - po vazhdojmë më pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës. Realizimi i planit Objektivat e menaxhimit të mbeturinave dhe plani operacional 2024. E hapi diskutimin, pasi që nuk ka diskutime.	
Kryesuesi i Kuvendit - Hedh në votim: Miratohet unanim nga anëtarët e KPF-së. Gjashtë anëtarë prezent në sallë.	
Vendimet:	
Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja unanim, ia kalon Kuvendit të Komunës për shqyrtim Raportin e Realizimit të planit Objektivat e menaxhimit të mbeturinave dhe plani operacional 2024.	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 12.	
Diskutimet:	
Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova, - po vazhdojmë më pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës. Raporti i Planit të Veprimit për Energji të Qëndrueshme dhe Klimë. E hapi diskutimin, pasi që nuk ka diskutime.	
Kryesuesi i Kuvendit - Hedh në votim: Miratohet unanim nga anëtarët e KPF-së. Gjashtë anëtarë prezent në sallë.	

Vendimet:	
Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja unanim, ia kalon Kuvendit të Komunës për shqyrtim Raportin e Planit të Veprimit për Energji të Qëndrueshme dhe Klimë.	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 13.	
Diskutimet:	
Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova, - po vazhdojmë më pikën e trembëdhjetë të rendit të ditës. Shqyrtim dhe miratimi i Propozim-Vendimit për rishqyrtimin e Vendimit 00 Nr.163/2024 për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2025. Genc Ademaj- gabimi është te baza ligjore është dashur t'i shtohet edhe një nen i ligjit. Duhet që zyrtarë ligjor të jenë pak më të kujdesshëm dhe mos të kemi probleme teknike sepse nganjëherë po nguten dhe shumë herë po ndodhë që po kthehen për shkak të mos kompletimit të bazës ligjore. E di që është shumë vështirë të përcillen ligjet sepse vazhdimisht ndryshojnë, njerëz jemi gabojmë. Kryesuesi i Kuvendit- çeshtjet teknike, ka pasur raste që kam shkuar vet në ministri, dhe ka dalë që kem shkuar për asgjë sepse ndodhë që edhe atje gabojnë. Për çeshtjet e vendimeve, zyra ligjore është përgjegjës totale, ne si kuvend veç jemi një filter që duhet të kryhen këto punë. Kryesuesi i Kuvendit - Hedh në votim: Miratohet unanim nga anëtarët e KPF-së. Gjashtë anëtarë prezent në sallë.	
Vendimet:	
Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja unanim, ia kalon Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim Propozim-Vendimin për rishqyrtimin e Vendimit 00 Nr.163/2024 për caktimin normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2025.	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 14.	
Diskutimet:	
Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova, - po vazhdojmë më pikën e katërmëdhjetë të rendit të ditës: Plotësim -Ndryshimi i Rregullores 00 Nr. 177/2024 për Taksa Ngarkesa dhe Gjoha. Këtu mbetem t'i shtojm ato nene. Pasi që nuk ka diskutime. Kryesuesi i Kuvendit - Hedh në votim: Miratohet unanim nga anëtarët e KPF-së. Gjashtë anëtarë prezent në sallë.	
Vendimet:	
Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja unanim, ia kalon Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim Plotësim -Ndryshimin e Rregullores 00 Nr. 177/2024 për Taksa Ngarkesa dhe Gjoha.	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim:		Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 15.		
Diskutimet:		
Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova, - po vazhdojmë më pikën e pesëmbëdhjetë të rendit të ditës Rishqyrtimi i Rregullores 00 Nr. 189/2024 për Shitjen e Mallrave, Artikujve dhe shërbimeve tjera jashtë lokaleve afariste.		
Kryesuesi i Kuvendit - Hedh në votim: Miratohet unanim nga anëtarët e KPF-së. Gjashtë anëtarë prezent në sallë.		
Vendimet:		
Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja unanim, ia kalon Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim Rishqyrtimi i Rregullores 00 Nr. 189/2024 për Shitjen e Mallrave, Artikujve dhe shërbimeve tjera jashtë lokaleve afariste.		
Personat përgjegjës për zbatim:		Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:		Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 16.		
Diskutimet:		
Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova, - po vazhdojmë më pikën e gjashtëmbëdhjetë të rendit të ditës Njoftimi me Raportin Vjetor për kontratat e nënshkruara publike.		
Genc Ademaj- prezanton pikën e rendit të ditës 'Njoftimi me Raportin Vjetor për kontratat e nënshkruar publike.		
Kryesuesi i Kuvendit- pasi që nuk ka diskutime.		
Kryesuesi i Kuvendit - Hedh në votim: Miratohet unanim nga anëtarët e KPF-së. Gjashtë anëtarë prezent në sallë.		
Vendimet:		
Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja unanim, ia kalon Kuvendit të Komunës për shqyrtim Njoftimin me Raportin Vjetor për kontratat e nënshkruara publike.		
Personat përgjegjës për zbatim:		Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:		Deri në mbledhjen e kuvendit
Pasi që përfunduan pikat për këtë rend dite, falënderoj për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë. Shpalli të mbyllura punimet për këtë mbledhje.		
Mbledhja përfundoj :		11: 30.

Procesmbajtëse,
Znj. Flora Bujupaj

FB

Kryesuesi i Kuvendit,
z.Enver Rugova

ERugova

